

**AKT THEMELIMI  
DHE STATUTI I SHOQËRISË  
“FERME NESHAT MULITA”**

Sot, më 08.06.2022, unë i nënshkruari Neshat Mulita, lindur më 17.07.1987, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: I70717068U, i perfaqesuar nga znj. Fjoralba Hoxha, sipas prokures se per gjithshme nr. 498 Rep, nr. 238 Kol, date 07.02.2022 dhe unë i nënshkruari Maksim Caslli, lindur më 03.07.1967, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: G70703114C, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “**American Capital**”, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (**NUIS**): K91616024E dhe seli në adresën “*Rruga Jordan Misja, Kompleksi Ushgja, kati 2, Tirane*”, themelojmë një shoqëri si më poshtë vijon dhe miratojmë statutin e kësaj shoqërie.

*I EMËRTIMI - SELLA - FORMA JURIDIKE - OBJEKTI*

**Neni 1**  
**Emërtimi**


- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është “**FERME NESHAT MULITA**”.

**Neni 2**  
**Forma ligjore**

- 2.1 Shoqëria do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) sipas Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeter juridike nëse vendoset nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 3**  
**Personaliteti juridik**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me nenet e këtij Statuti, Aktit të themelimit, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.



#### **Neni 4**

##### **Selia e shoqërisë**

- 4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Devoll, Gjyres, Pasuria me numër 40/4, zona kadastrale 1776, Devoll, Shqipëri.
- 4.2 Shoqëria mund të çelë filiale, seli dytësore, degë apo zyra përfaqësie në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

#### **Neni 5**


##### **Emblema/vula**

- 5.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.
- 5.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 6**

##### **Objekti i shoqërisë**

- 6.1 Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Import – Export, shitje te tregti me pakice, mbarshtim bagetish, i gjedheve te trasha dhe te imta dhe aktivitete te tjera te lidhur me veprimtarine etj. Per permbyshjen e objektit, shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari tjeter te natyres financiare e tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tregtar, si dhe te jape garanci, dorezani, te marre hua dhe ofroje garanci, pasurore apo personale, ne favor te te tretave. Te jape konsulence menaxheriale dhe financiare dhe keshillime te tjera. Me ne pergjithesi, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise. Për permbyshjen e objektit, shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari tjeter të natyrës financiare e tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 6.2 Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional pér arritjen e qëllimeve të shoqërisë, si dhe të japë garanci, dorëzani, të marrë hua dhe ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tretëve. Më në pergjithësi, Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm pér realizimin e qëllimeve të shoqërisë.
- 6.3 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.



### **III. KOHËZGJATJA-KAPITALI I SHOQËRISË**

#### **Neni 7**

##### **Kohëzgjatja**

- 7.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç prishjes së saj sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.
- 7.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 8**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

- 8.1 Kapitali i shoqërisë është 100,000.00 Leke (njeqind mijë) dhe ndahet në 2 pjesë kapitali. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar por jo shlyer plotësisht në para nga ortakët:

- **American Capital Shpk.**, një shoqëri e krijuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën Rruga Jordan Misja, Kompleksi Usluga, kat 2, Tirane, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër unik të regjistrimit (NUIS) K91616024E, zoteron 1 kuote, përbërëse e 50% (pesëdhjetë) të kapitalit te Shoqerise, me vlerë nominale 50,000.00 Leke (pesedhjete mijë);
- **Z. Neshat Mulita**, zoteron 1 kuote, që përbën 50% (pesedhjetë) të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 50,000.00 Leke (pesedhjete mijë).

#### **Neni 9**

##### **Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 9.1 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve. Në këtë rast ortakët kanë të drejtën e parablerjes.
- 9.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje (në vijim "Njoftimi"), (a) numrin e kuotave të ofruara; (b) emrin e blerësit/përfituesit; (c) çmimin e rënë dakort pér çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshtpërbllimi tjeter të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksiuni, dhe çdo rast tjeter transferimi me shpërbllim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërbllim; (d) modalitetet e pagesës; (e) ftesën pér të ushtruar të drejtën e parablerjes. Afat dhe kushtet e mundshme pér të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të janë detyruar pér ortakët e tjerë të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar pér shitje.
- 9.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, pér t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre pér të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr

Faqe 3 nga 8

dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

- 9.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zoterojnë, përvëç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 9.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'u transferohen të tretëve sipas çmimit të specifikuar në të.

## Neni 10


### Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë

- 10.1 Ortakët mund të zmadhojnë kapitalin e Shoqërisë vetëm me vendim të Asamblesë së ortakëve e cila vendlodhet me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit nga njeri prej ortakëve, nuk detyron ortakët e tjerë të zmadhojnë pjesët e tyre; pjesët e kapitalit të ortakëve që nuk marrin pjesë në zmadhim, zvogëlohen në përpjesëtim me kapitalin e shoqërisë.
- 10.3 Vendimi për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë mund të risistemojë edhe numrin dhe vlerën e pjesëve të kapitalit.
- 10.4 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të realizohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakët që hyjnë në Shoqëri, të cilët do të pranohen si të tillë me vendim të ortakëve, në të njëjtën mbledhje asambleje gjatë të cilës do të vendoset zmadhimi i kapitalit në këtë mënyrë.
- 10.5 Asambleja e ortakëve mund të vendlodhet kryerjen e financimeve nga ana e ortakëve por që nuk përbëjnë mbledhje kursimesh nga publiku në përputhje me ligjet fiskale dhe bankare. Shumat e derdhura mund të përdoren përmes mbulimin e humbjeve ose për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë apo përmes qëllime të tjera të parashikuara në objektin e veprimtarisë së Shoqërisë. Ortakët mund të kërkojnë të përcaktohet përdorimi dhe kohëzgjatja e financimit.

## Neni 11

### Zvogëlimi i kapitalit

- 11.1 Zvogëlimi i kapitalit do të kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin “Për shoqëritë tregtare”. Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që zoterojnë.
- 11.2 Projekti i zvogëlimit i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë të thirrur për këtë arsy. Eksperti kontabël shqyrton projektin dhe ia paraqet ortakëve raportin e tij lidhur me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit.
- 11.3 Asambleja miraton raportin dhe zvogëlimin me vendim unanim.




## *. ORGANET E SHOQËRISË*

### **Neni 12 Asambleja e Ortakëve**

- 12.1 Vendimet merren nga Asambleja e Ortakëve.
- 12.2 Asambleja e Ortakëve shqyrton dhe vendos për çështjet e mëposhtme (por pa u kufizuar vetëm në këto):
  - ndryshimi i selisë ose hapja e zyrave të reja;
  - ndryshimi i emërtimit të shoqërisë;
  - zmadhimi dhe/ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
  - blerja dhe/ose transferimi i pjesëve të kapitalit të shoqërisë të tretëve;
  - emërimi dhe/ose shkarkimi i administratorit/administratorëve;
  - prishja dhe likuidimi i Shoqërisë;
  - transformimi i Shoqërisë nga SHPK në një formë tjetër;
  - miratimi i bilancit të Shoqërisë.

### **Neni 13 Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vtit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe te inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga njëri prej Administratorëve me iniciativën e tij ose sipas kërkeses me shkrim që do tu drejtohet Administratorëve nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, që duhet t'u dërgohet ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpëra mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vandin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, edhe jashtë shtetit.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhynë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të janë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vandin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes ose noteri publik.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.




- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë të paktën 75% (shtatedhjete e pese përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e ortakëve te pranishëm që zoterojnë të paktën 75% (shtatedhjete e pese përqind) të kapitalit themeltar. Me mazhorancën e mësiperme Asambleja e Ortakëve mund të Autorizojet e Shoqërisë duke shfuqizuar ndalimin sipas nenit 17.1 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Cdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë përsone tjeter i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

#### Neni 14

#### Organi i administrimit

- 14.1 Asambleja e ortakëve ka të drejtën të vendosë nëse administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë administratorë.
- 14.2 Administrimi i Shoqërisë i cili konsiston në kryerjen e të gjithë veprimeve të administrimit për realizimin e objektit të veprimitarisë së Shoqërisë, i besohet administratoreve të perbashket.
- Administratori i vetëm ose administratorët (nëse janë emëruar) qëndrojnë në detyrë për 5 (pesë) vite përvèç nëse shkarkohen nga Asambleja e ortakëve. Kushdo që administrion Shoqërinë përgjigjet personalisht përballë saj dhe të tretëve për shkelje të mundshme të Ligjit dhe/ose Statutit dhe/ose përgjithësia e gjysmëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit, mund të ndërmarrë iniciativa gjyqësore për shpërbimin e démit të shkaktuar nga mosrespektimi i këtyj nenit.
- Administratorë të Shoqërisë janë:
1. **Z. Neshat Mulita**, lindur më 17.07.1987, me dokument identifikimi me nr. personal I70717068U, me banim në Tiranë, Shqipëri, për një afat deri më 08.06.2027;
  2. **Z. Qazim Kokoshi**, lindur me 23.08.1967, me dokument identifikimi me nr. personal G70823070R, me banim në Tiranë, Shqipëri, për një afat deri më 08.07.2022;
- 14.3 Administratori i vetëm ose administratorët nuk mund të kenë interesa në shoqëri të tjera me konflikt interesit të hapur dhe janë të detyruar të njoftojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve verifikimin e këtyre situatave. Shoqëria, me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit, mund të ndërmarrë iniciativa gjyqësore për shpërbimin e démit të shkaktuar nga mosrespektimi i këtyj nenit.
- 14.4 Administratori mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Asamblesë së ortakëve, me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të Shoqërisë; pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bërë pa arsyë të drejtë, lihet shkak për dëmshpërbimin financiar.



**Neni 15**  
**Viti ushtrimor**

15.1 Vitet ushtrimore përputhen me vitet kalendarike, ato fillojnë më 1 Janar dhe mbarojnë më 31 Dhjetor të çdo viti.

**Neni 16**  
**Bilanci. Kontabiliteti.**

- 16.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve fiskale brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhë dhe monedhë shqiptare.
- 16.3 Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët ose institucione financiare shqiptare apo ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të ofrojë garanci, hipotekë ose peng me kusht që të jetë autorizuar nga Asambleja e ortakëve.

**Neni 17**  
**Fitimet. Dividentët**


- 17.1 Për të realizuar objektin e veprimtarisë, Shoqëria duhet të ketë aftësi financiare të nevojshme.
- 17.2 Fitimet që rezultojnë nga mbyllja e vitit ushtrimor, pas pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera ligjore, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në përpjesëtum më pjesët e kapitalit të zotëruara.
- 17.3 Humbjet e Shoqërisë do të mbulohen brenda kufirit të kapitalit të Shoqërisë dhe çdo ortak do të përgjigjet për pjesët e tij të kapitalit.

**Neni 18**  
**Likuidimi**

- 18.1 Shoqëria do të likuidohet kur të vendoset prishja e saj nga Asambleja e ortakëve.
- 18.2 Procedurat e likuidimit do të kryhen nga një likuidator ose nga një grup likuidatorësh të emëruar nga Asambleja e ortakëve.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin duke shqyrtuar aktivin dhe pasivin e Shoqërisë, duke kryer veprimet përkatëse të likuidimit brenda kohës së nevojshme për likuidimin. Në fund të këtij procesi, Asambleja e ortakëve analizon bilancin përfundimtar dhe mbylljen e procedurave të likuidimit.
- 19.4 Në çdo rast respektohen dispozitat e ligjit tregtar.

**Neni 19**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 19.1 Autoriteti gjyqësor shqiptar do të ketë kompetencë ekskluzive për zgjidhjen e të gjithë mosmarrëveshjeve ndërmjet ortakëve që nuk janë zgjidhur miqësisht.



**Neni 20**  
**Ligji i zbatueshëm**

- 20.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Statut, referencë bëhet në legjislacionin e zbatueshëm shqiptar në fuqi.  
20.2 Ky Statut hartohet në 2 (dy) kopje autentike në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 09/06/2022

**ORTAKËT**

**Per American Capital sh.p.k.**

**Z. Maksim Caslli**

Maksim Caslli  


**Z. Neshat Mulita**  
Perfaqesuar nga Znj. Fjoralba Hoxha  
*sipas prokures se per gjithshme nr. 498*  
*Rep, nr. 238 Kol., Date 07.02.2022*

Fjoralba Hoxha 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MIMOZA SADUSHAJ  
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1  
Tirane  
TEL: 0692097547**

## **PROKURË E PËRGJITHSHME**

Nr. repertori: 498

Nr. koleksioni: 238

Tirane më 07/02/2022

Ligjet referuese:

- 1.Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar
- 3.Liqji nr. 110, date 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022053540027215094



## PROKURË E PËRGJITHSHME

Sot, më datë 07/07/2022 (dymije e njezet e dy), permeje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqiten personalisht:

**I PERFAQESUAR:Neshat Mulita**, atësia Bashkim, amësia Drita, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 6; H. 2; Ap. 29; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 17/07/1987, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036837677 dhe nr. personal I70717068U.

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja hartimin e kësaj prokure të përgjithshme në bazë të neneve nr. 64, 71 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 62, pika 1, germa “ll”, neni 63, pika 1, germa “ç”, neni 99 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, si më poshtë vijon:

“Unë i përfaqësuari i mësipërm, emëroj si përfaqësues të përgjithshëm **Fjorbalba Hoxha**, atësia Bashkim, amësia Drita, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në TIRANË, me adresë Taulantia; Nd. 8; H. 6; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1010; Tiranë, lindur më 05/08/1982, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035479661 dhe nr. personal I25805187D, te ciles i jap te drejte dhe kompetence te plete qe ne emer dhe per llogarine time:

Te paraqitet prane cdo personi fizik e juridik, zyre noterie, zyre avokatie apo ekspertize, zyre vendore dhe qendrore e regjistrimit te pasurive te paluajtshme, ne Republiken e Shqiperise, arkive, zyrat e ujesjellesit dhe OSHEE, gjykate si dhe kudo qe do t'i paraqitet e nevojshme te depozitoje ose te terheqe prej tyre dokumenta duke nenshkruar prane tyre gjithcka qe do te jete e nevojshme si dhe te kryeje pa kufizim veprimet ku kerkohet prania jone. perfaquesuesja ime ka te drejte te beje apikime, kerkesa, te kryeje procedurat per rivleresimin e pasurive te paluajtshme te cilat jane ne pronesine time.

Perfaquesuesja ka te drejte te paraqitet prane cdo zyre noterie, per te nenshkruar ne emrin tim kontrata per shitjen dhe blerjen e pasurive te paluajtshme, duke i nenshkruar kontratat me kushtet dhe çmimet qe ai i konsideron te arsyeshme. perfaquesuesja ka te drejte te nenshkruaje Kontrata premtim shitje, kontrata shitje me kusht, kontrata shitje me kusht kreditimi etj. perfaquesuesja ka te drejte qe ne rast se do te jete e nevojshme te dale edhe si hipotekues i perkohshme ne rast se çmimi i shitjes do te paguhet me kredi nga pala blerese. perfaquesuesja ka te drejte te kaloje ne llogarine e tij çmimin e shitjes te perfituar nga shitja e pasurive te paluajtshme ne pronesine time.

Perfaquesuesja im ka te drejte te paraqitet prane cdo zyre noterie, per te nenshkruar Kontrata sipermarrje duke gjetur vete palen tjeter kontraktuese, te percaktoje perqindjen, afatin, kushtet e kontrates, aneks per per percaktimin e pjeseve takuese, kontrate shkembimi, amendim per shtyrje afati te kontrates se sipermarrjes, amendim kontrate per shtyrjen e afatit te martjes se lejes ne bashkë, Kontrata Komisioni, Kontrata ndermjetesimi, Kontrata porosie, Kontrata qiraje, kontrata huapendorje, kontrata pjestimi, revokim kontratas, deklarata noterie, likuidimi apo te formave te tjera.



A2022053540027215094

Perfaqesuesja im i pergjithshem i percaktuar ne kete prokure gjithashtu kane te dreje te jete vete pale pranuese dhurimi, pale blerese, pale sipermarrese, pale pranuese e te drejtave reale mbi pasurine, duke i shitur, dhuruar, duke i kaluar te drejtat reale mbi pasurine edhe vetes se tij, sipas parashikimeve te nenit 67 te Kodit Civil.

Perfaqesuesja ka te dreje t'i administrojne pronat ne pronesine time, t'i mirembaje dhe t'i perdori duke pasur te gjitha te drejtat e administrimit si dhe te nenshkruaje cfareolloj akti per administrimin e pronave.

Perfaqesuesja im ka te dreje te paraqitet prane cdo zyre notierale, per te nenshkruar Kontrata qiraje, kontrata huaperdorje, kontrata pjestimi pasurie, revokim kontratash, deklarata notierale, likuidimi apo te formave te tjera.

Perfaqesuesja im i pergjithshem ka te dreje qe ne emer dhe per llogari time te paraqitet prane Komisionit te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave, ne nivel lokal dhe qendor, prane Agjensive te Privatizimit, apo kujtdo enti e organi shteteror ne nivel lokal dhe qendor per te aplikuar, kerkuar dhe perfituar dokumentacionin e akte te nevojshme ne interes dhe me synim perfitimin e se drejtes se pronesise mbi pronat qe me perkasin.

Perfaqesuesja ka te dreje te vendose si garanci pronat ne pronesine time, ne rast te marjes se kredive prane te gjithe bankave pa kufizim, nga une vete ose persona te trete, duke pasur te dreje te nenshkruaje kontrata kredie, kontratat e hipoteke, ndryshim kontrata si dhe cdo kontrate tjeter te nevojshme per vendosjen e ketyre garancive. perfaqesuesja im ka te dreje te kryeje cdo veprim tjeter te nevojshem per permbushjen e ketyre procedurave.

Perfaqesuesja ka te dreje te na perfaqesoje ne Gjykatat e Rrethit Gjyqesor, si dhe ne te gjitha shkallet gjyqesore, ne cfareolloj gjykimi civil apo penal ne te cilin ne mund te jemi pale e paditur, pale paditese ose pale e interesuar. perfaqesuesjet ka te dreje te hartoje dhe firmose kerkese padi, ankime, rekurse te shtoje dhe pakesoje objektin e padise te kundershtoje veprimet e ndermjetme, te ndryshoje shkakun ligjor te saj te kerkoje zevendesime, thirrjen e personave te trete, te therrase dhe te kerkoje perjashtimin e eksperteve, te kerkoje ekspertime, riekspertime, e ti kundershtoje ato, te kerkoje perjashtim te trupit gjykues, e gjyqtareve ne vecanti, te me perfaqesoje ne te gjitha seancat gjyqesore, ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor te cilidlo rreth dhe ne te gjitha shkallet e tjera gjyqesore ne Gjykaten e Apelit dhe Gjykaten e Larte. Te ekzekutoje vendimin e gjykates nepermjet zyres se permbarimit dhe ndjekjen prej tij te ekzekutimit te vendimit gjyqesor te formes se prere prane Gjykates dhe prane zyres se permbarimit perkatese, me te gjitha te drejtat e parashikuara ne ligj. perfaqesuesja im ka te dreje te heqe dore nga ceshtjet gjyqesore, dhe ti zgjidhe ato me mirkuptim. Persa me siper perfaqesuesja im ka te dreje te emeroje edhe avokate duke i deleguar te gjitha apo dhe disa nga keto te drejta qe perfaqesuesja im i ka ne kete paragraf.

Perfaqesuesja ka te drejta dhe kompetenca te plota ligjore te paraqiten prane Bankave te Nivelit te Dyte, ne emer dhe per llogari time, te drejten per te depozituar, terhequr, per te kryer transfertat, duke nenshkruar ne emer dhe per llogari time cdo lloj dokumenti bankar qe do te jete i nevojshem per realizimin e kompetences se dhene. perfaqesuesja im ka te dreje te paraqitet prane cdo banke niveli te dyte ne Republiken e Shqiperise, per te nenshkruar per emer dhe ne llogarine time dokumentet e nevojshme qe do te nevojiten per mbylljen e llogarive ne emrin tim, te kryeje pagesa komisionesh, te beje terheqje vertetimesh dhe gjendje llogarish, te kryeje terheqje fondesh pa kufizim, nga te gjitha llogariite, te beje depozitime, transferta brenda apo jashte vendimit, rinovime depozitash, thyerje depozitash, nga te gjitha llogarite e mia te tashme dhe te ardhshme. Te kryeje pagesa kredie, mbyllje te parakohshme kredie, terheqje fondesh nga llogaria e kredise ose depozitime, te beje kerkesa per lirim e



A2022053540027215094

kolateralit, te terheqe deklaraten e kolateralit, te kryeje pagesa karta krediti. Te terheqe karta krediti/debiti sebashku me pinin/kodin perkates. Te aplikojë per e-banking apo mobile banking duke u pajisur me te gjitha kodet, emrin e perdoruesit (username), fjalekalimet e te tjera.

Perfaqesuesja ka te drejte te gjeje, emeroje, dhe autorizoje perfaqesues te tjere, duke u dhene atyre tagra dhe te drejta perfaqesimi per te vepruar per te gjitha apo pjese te drejtave te cituara me siper ashtu sic ai do ta gjykoje te arsyeshme dhe te nevojshme per pronat te mia.

Perfaqesuesja ka te drejte te kryeje dhe cdo veprim tjeter qe une nuk e kam parashikuar shprehimi qe kete prokure por qe eshte i nevojshem per realizimin e kompetencave te dhena me ane te kesaj prokure.

Kjo prokurë e përgjithshme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e shfuqizimit të saj në çdo kohë. I përfaqësuari deklaroi se: "Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesja ime i përgjithshëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislationi në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëgena, sikur të ishin kryer prej vetë meje". Prokura e Përgjithshme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarit, i cilai e kuptoi përbajtjen e saj dhe meqenëse shprehë vullnetin e tij të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përparrë meje Noteres. Kjo Prokurë e Përgjithshme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarit. Njëra kopje vendoset në arxivën notieriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përpunohje të plotë të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", neni 62, neni 63 dhe neni 99 i tij; vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", me ndryshimet; Unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj prokure, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

## I PERFAQESUAR

Neshat Mulita

